

Banka e Shqipërisë

RAPORTI GJASHTËMUJOR PËR ECURINË E  
"KËRKESES MINIMALE PËR INSTRUMENTE  
TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE  
DETYRIME TË PRANUARA-MREL"

GJASHTËMUJORI I PARË I VITIT 2024

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408


E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)



# P Ë R M B A J T J A

PËRMBLEDHJE	4
I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL	6
II. STRUKTURA E FINANCIMIT TË MREL	8
III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL	12
IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR	14



## PËRMBLEDHJE

Ky raport përmbledh zhvillimet kryesore të sektorit bankar në terma të përmbushjes së "Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar"- MREL. Raporti i parë u hartua në fillim të vitit 2024 dhe analizonte zhvillimet kryesore që prej vitit 2021, pas hyrjes në fuqi të rregullores nr. 78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar", me fokus të veçantë fundin e vitit 2023. Ky raport përfaqëson raportin e dytë në radhë dhe përqendrohet në zhvillimet e ndodhura gjatë gjashtëmujorit të parë 2024 në ecurinë dhe përmbushjen e "Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar"- MREL. Raporti do të vijojë të përditësohet në terma gjashtëmujore.


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, janë 5 banka të sektorit bankar që i nënshtrohen kuadrit rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përmbushur kërkesën për MREL. Për këtë gjashtëmujor, këto banka kanë ruajtur një kontribut të qëndrueshëm në zhvillimet e sektorit bankar, duke zënë një peshë prej rreth 75% të aktiveve të sektorit dhe 73% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR).

Sektori bankar përmbushi plotësisht kërkesën e ndërmjetme për MREL. Objektivi i ndërmjetëm i kërkesës për MREL për vitin 2024, arrin mesatarisht në 18.2% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kundrejt objektivit të ndërmjetëm të vitit 2023 prej 16.4%. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar e ka përmbushur plotësisht objektivin e ndërmjetëm, duke ruajtur një kapacitet mesatar të MREL-it në nivelin 21.6% të EPR-ve.

Bankat janë aktive në financimin e plotë të kërkesës përfundimtare për MREL. Objektivi përfundimtar që duhet të përmbushet brenda vitit 2027, mesatarisht qëndron në nivelin 24.9% të EPR njësoj me një vit më parë, duke reflektuar mosndryshim të kërkesës mbikëqyrëse për kapital shtesë. Emetimi i titujve financiarë me përparësi të lartë (senior) gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, ka tkurrur hendekun negativ të sektorit për përmbushjen e objektivit përfundimtar të MREL. Mesatarisht, hendeku negativ është zvogëluar në nivelin prej 3.3% të EPR për qershor 2024, kundrejt nivelit 3.5% që shënonte në dhjetor 2023.

Kapitali rregullator përbën burimin kryesor të financimit të MREL, ndërsa titujt financiarë senior përbëjnë rishtazi peshën kryesore të detyrimeve të pranuar. Në qershor 2024, kapitali bazë i nivelit të parë ka financuar nivelin e MREL me 18.6% të EPR, kapitali i nivelit të dytë ka financuar 1.4% të EPR, borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator ka një kontribut më të ulët në 0.5% të EPR, ndërsa titujt financiarë senior kanë rritur financimin në rreth 1.1% të EPR.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2024, shënon nivel të moderuar të aktivitetit të bankave për emetimin e titujve financiarë për qëllime të kërkesave



**rregulative, kundrejt vitit 2023.** Gjatë kësaj periudhe, bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL emetuan në tregun e kapitalit në formën e obligacioneve me ofertë private, tituj borxhi të pagarrantuar.

**Kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur këto emetime mbetet i kënaqshëm.** Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, titujt financiarë të miratuar për emetim janë blerë nga investitorët në treg, në të cilin individët përbëjnë bazën kryesore të investitorëve<sup>1</sup>.

**Normat e interesit në tregun e kapitalit kanë shënuar ulje, në reflektim të zhvillimeve në tregun financiar, ofertës së titujve dhe natyrës së borxhit të pagarrantuar.** Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024, normat e interesit kanë shënuar një ulje prej rreth 2.2% për emetimin në lekë, 0.7% për euron dhe 1.7% për dollarin amerikan, krahasuar me totalin e emetimeve për vitin 2023.

**Maturiteti i letrave me vlerë të emetuara në tregun e kapitalit në Shqipëri reflekton një rënie të lehtë.** Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, emetimi i titujve të borxhit të pagarrantuar, i realizuar në monedhën kombëtare dhe në monedhë të huaj, është bërë për afate më të ulëta maturimi, prej 3 vjetësh, nga 4 vjet që ishte në gjashtëmuajorin e mëparshëm.

**Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL paraqesin zhvillime pozitive në përfitueshmëri, në linjë me zhvillimet e sektorit.** Në fund të gjashtëmuajorit të parë 2024, rezultati neto nga interesi për këto banka u rrit me 11% në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 26.3 miliardë lekë. Marzhi neto nga interesi shënoi gjithashtu, përmirësim të ndjeshëm, në nivelin historik prej 4.29% kundrejt nivelit prej 4.25% në fund të vitit 2023.

**Në vijim të zhvillimeve të kënaqshme në treguesit e përfitueshmërisë, kosto e financimit të kërkesës për MREL vlerësohet e përballeshme.** Në fund të gjashtëmuajorit të parë 2024, shpenzimet për interesa për borxhin e varur përbëjnë 2% të rezultatit neto nga interesi, për bankat, të cilat i nënshtrohen kërkesës për MREL. Banka të veçanta, të cilat kanë një histori më të gjatë të emetimit të titujve të borxhit për qëllime rregulative, kanë një peshë më të lartë të këtij treguesi, i cili gjithsesi mbetet i kufizuar në ndikimin që ka në përfitueshmëri.

**Simulimet në lidhje me ndjeshmërinë e koston së financimit të MREL ndaj rritjes së normës së interesit në treg, tregojnë për aftësi të mira të përthithjes së koston shtesë për sektorin bankar.** Gjithsesi, banka të veçanta, të cilat kanë një varësi më të lartë nga financimi i titujve të borxhit në treg për shkak të nivelit më të ulët të kapitalit rregullator, shfaqin një ndjeshmëri më të lartë.

<sup>1</sup> Sipas nenit 11, të Rregullores nr 78/2020, për qëllime të përmbljes së "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar", njohja e instrumenteve të detyrimeve të pranuar që zotërohen nga klientët joprofesionistë, bëhet pasi banka kryen testin e përshtatshmërisë, sipas dispozitave të ligjit "Për tregjet e kapitalit" dhe përcakton se, në bazë të testit të kryer "...instrumenti është i përshtatshëm për klientin joprofesionist". Dokumentimi i kryerjes së testit të përshtatshmërisë bëhet sipas dispozitave të ligjit "Për tregjet e kapitalit".




## I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL


Me hyrjen në fuqi të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, Banka e Shqipërisë ka komunikuar kërkesën për MREL për secilën bankë që prej vitit 2021, në përputhje me strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në zbatim të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë periodike përmbushjen e kërkesës për MREL.

Për vitin 2024, 5 nga 11 bankat e sektorit duhet të përmbushin kërkesën për MREL në zbatim të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të identifikuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo strategji nënkupton që këto banka duhet të mbajnë në bilancin e tyre burime të mjaftueshme financiare, të cilat mund të zhvlerësohen dhe të konvertohen në kapital, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë raport, grupi i bankave që duhet të përmbushin kërkesën për MREL identifikohet si “bankat MREL”.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, pesha e bankave MREL sipas aktiveve totale dhe nivelit përkatës të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR), ka shënuar një rënie të lehtë kundrejt fundit të vitit 2023, por mbetet brenda intervalit të këtij treguesi për vitet 2021-2023. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, këto banka përbëjnë mesatarisht 75% të totalit të aktiveve dhe 73% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR) të sektorit bankar. Kjo ecuri reflekton një kontribut relativisht të qëndrueshëm të aktivitetit të grupit të bankave MREL në zhvillimet e sektorit bankar gjatë periudhës së hyrjes në fuqi të kërkesave rregullative me fokus ndërhyrjen e jashtëzakonshme.




Në zbatim të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, Banka e Shqipërisë komunikon




çdo vit, nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL që bankat duhet të plotësojnë brenda 12 muajve të ardhshëm, dhe nivelin përfundimtar që duhet të plotësohet brenda vitit 2027. Për vitin 2024, objektivi i ndërmjetëm i kërkesës për MREL, është rritur në 18.2% të EPR dhe ai përfundimtar qëndron në 24.9% të EPR. Niveli i ndërmjetëm i kërkesës për MREL për vitin 2024, është rritur në terma mesatare me 1.8% të EPR, ndërsa ai përfundimtar nuk shënoi ndryshime, duke reflektuar nivele të pandryshueshme të normës mbikëqyrëse shtesë të kapitalit për bankat MREL.

Referuar gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, sektori bankar paraqitet në përmbushje të plotë të objektivit të ndërmjetëm të MREL për vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe, kapaciteti i bankave për kërkesën për MREL është luhatur në intervalin 18.8% - 27.4% të EPR, duke qëndruar ndjeshëm mbi nivelin minimal të komunikuar nga Banka e Shqipërisë.



Gjatë periudhës, sektori bankar ka shënuar një përmbushje të plotë të objektivit të ndërmjetëm për MREL për secilin tremujor, me një tepriçë që luhetet nga 3.0% deri në 3.4% të EPR. Në lidhje me objektivin përfundimtar, sektori bankar e ka zvogëluar hendekun negativ që duhet të plotësojë deri në vitin 2027, nëpërmjet emetimeve të reja të titujve financiarë me fokus financimin e MREL. Për rrjedhojë, në qershor 2024, hendeku negativ që duhet të përmbushin bankat brenda vitit 2027, është ulur në 3.3% të EPR-ve kundrejt 4.7% që shënonte në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023. Gjithashtu, ky pozicion ende nuk i reflekton plotësisht titujt financiarë të nënshkruar nga sektori bankar gjatë vitit 2023, të cilat pritet të disbursohen gjatë periudhës 2024-2027, në linjë me afatin përfundimtar të përmbushjes së kërkesës MREL.





Në nivel individual, bankat, të cilat kanë një pozicion të kapitalit rregullator poshtë nivelit të sektorit, paraqesin një hendek më të lartë të nevojës për financim të MREL-it. Megjithatë, edhe për këto banka ky hendek ka shënuar rënie. Me gjithë përmirësimin e lehtë të treguesit, këto banka duhet të vijojnë me përqasjen proaktive të financimit gradual të kërkesës për MREL, në përputhje me objektivat vjetorë që do të komunikohen nga Banka e Shqipërisë.

## II. STRUKTURA E FINANCIMIT TË MREL


Gjatë periudhës 2022-2023 sektori bankar është mbështetur kryesisht në zërat e kapitalit rregullator dhe borxhin e varur për përmbushjen e kërkesës për MREL. Tremujori i fundit i vitit 2023, ka reflektuar zhvillime të reja në sektorin bankar, përmes emetimit për herë të parë të titujve financiarë me përparësi të lartë (senior), për qëllime të përmbushjes së kërkesave rregullative. Ndërkohë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 u shënuan emetime të titujve financiarë në trajtën e obligacioneve të pagarantuara, të emetuara si detyrime të pranuar.

Më konkretisht, në qershor 2024, stoku i kapitalit bazë të nivelit të parë për bankat MREL vijoi prirjen rritëse në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 137.3 miliardë lekë kundrejt nivelit 133.6 miliardë lekë që shënonte në fund të vitit 2023. Ky përmirësim reflekton ndikimin pozitiv të përfitueshmërisë së sektorit bankar në forcimin e vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit bazë. Gjatë pjesës së parë të vitit, kapitali rregullator i nivelit të dytë nuk ka shënuar zhvillime të reja dhe qëndron pothuajse në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2023, në 10.5 miliardë lekë.





Grafik 4. Struktura e financimit të MREL në milionë lekë, 2021- T2 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Detyrimet e pranuar<sup>2</sup>, që përbëhen kryesisht nga titujt financiarë më përparësi të lartë (senior), kanë shënuar një rritje të lehtë gjatë pjesës së parë të vitit 2024. Në nivel stoku, detyrimet e pranuar shënuan një rritje prej rreth 0.74 miliardë lekë kundrejt dhjetorit të vitit 2023, duke arritur në nivelin 11.2 miliardë lekë në qershor 2024. Ky stok përbëhet nga rreth 3.4 miliardë lekë borxh i varur i paklasifikuar si kapital rregullator, 4.8 miliardë lekë detyrime senior jopreferenciale dhe rreth 3.0 miliardë lekë detyrime (senior) me përparësi të lartë të pakolateralizuara. Detyrimet senior jopreferenciale shënuan rritje, duke reflektuar emetimin e obligacioneve të pagarantuara të bankave MREL.


Në terma të kontributit në kapacitetin e MREL (grafik 5), kapitali bazë i nivelit të parë përbën kontribuesin kryesor, duke financuar mesatarisht rreth 86% të totalit. Gjithsesi, nga tremujori i fundit i vitit 2023 deri në tremujorin e dytë të 2024, struktura e financimit të kapacitetit të MREL është ruajtur pothuajse e pandryshuar, ku pas kapitalit bazë të nivelit të parë, kapitali i nivelit të dytë ka kontribuar në vijimësi në strukturën e financimit të MREL, duke reflektuar aktivitetin e sektorit bankar në emetimin e borxhit të varur në tregun e brendshëm. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, ky kapital ka financuar mesatarisht rreth 7% të nivelit të MREL, duke ruajtur të njëjtat nivele që nga rritja e shënuar për tremujorin e fundit të vitit 2023. Kontributi që vjen nga borxhi i varur i paklasifikuar si kapital rregullator paraqitet i qëndrueshëm në rreth 2% të stokut të MREL, nga rreth 3% në fund të vitit 2023. Së fundi, detyrimet senior, me përparësi të lartë dhe ato jopreferenciale kanë financuar MREL me rreth 5% të totalit, duke reflektuar aktivitetin në rritje të sektorit bankar, të financimit të MREL me këto instrumente, të nisur që në gjysmën e dytë të vitit 2023. Financimi i

<sup>2</sup> Detyrimet e pranuar përbëhen nga (i) instrumentet që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 9, të Rregullores nr. 78/2020, "Kushtet për njohjen e instrumenteve për përmbushjen e "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar", në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të kapitalit të nivelit të dytë dhe (ii) instrumente të kapitalit të nivelit të dytë me maturimin e mbetur më të gjatë se një vit, në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit të nivelit të dytë, në përputhje me rregulloren "Për kapitalin rregullator".



strukturës së MREL me detyrime senior shënoi një rritje prej 1% kundrejt fundit të vitit 2023, duke paraqitur një strukturë të ngjashme dhe të qëndrueshme përgjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2024.


Grafik 5. Struktura e financimit të MREL në përqindje, 2021- T2 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kapitali bazë i nivelit të parë përbën mesatarisht 18.6% të EPR në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, kundrejt nivelit 18.5% në fund të vitit 2023 (grafik 6), ku rritja me 0.1% të EPR e kapitalit të nivelit të parë shpjegohet me kapitalizimin e fitimit për bankat MREL. Kapitali i nivelit të dytë ruan një qëndrueshmëri financimi në nivelin e 1.4 të EPR-ve për të gjithë periudhën, ndërsa borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator, ka ruajtur një kontribut të qëndrueshëm me rreth 0.5% të EPR gjatë gjysmës së parë të vitit 2024. Emetimet e titujve të njohur si detyrime senior, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për financimin e MREL. Në qershor 2024, ato arrijnë në total në rreth 1.1% të EPR nga rreth 0.8% në fund të vitit 2023, duke evidentuar rritjen e aktivitetit të sektorit bankar në emetimin e këtyre instrumenteve.


Grafik 6. Struktura e financimit të MREL në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, 2021- T2 2024.




Burimi: Banka e Shqipërisë.



Zhvillimet në ecurinë e kërkesës për MREL gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024 (grafik 7), kanë reflektuar strategjinë e re të sektorit bankar për të ulur varësinë e financimit përmes kapitalit rregullator dhe rritjen e financimit nëpërmjet instrumenteve senior.



Kontributi i këtyre zhvillimeve në rritjen e kapacitetit të MREL gjatë pjesës së parë të vitit 2024, është paraqitur në Grafikon 8. Në fund të tremujorit të dytë 2024, niveli i MREL është rritur në 21.6% të EPR nga 21.4% që shënonte në fund të vitit 2023, duke u përmirësuar me 0.2 pikë përqindje. Në këtë përmirësim, kontribut të rëndësishëm ka dhënë forcimi i kapitalit rregullator, përmes rritjes së kapitalit bazë të nivelit të parë me 0.5 pikë përqindje, ndërkohë që stoku i titujve të detyrimeve të pranuar (senior) ka kontribuar me një rritje prej 0.1 pikë përqindje. Stoku i borxhit të varur me maturitet të mbetur mbi 1 vit, i cili nuk klasifikohet si kapital rregullator, ka ruajtur një peshë të pandryshuar dhe kontribut të njëjtë në nivelin e MREL gjatë pjesës së parë të vitit 2024.




Sektori bankar në Shqipëri ka vijuar zgjerimin e aktivitetit bankar gjatë periudhës. Për gjashtëmujorin e parë 2024, ekspozimet e ponderuara me rrezik të sektorit kanë shënuar një rritje prej 7.6% në terma vjetorë dhe prej 4.9% në terma gjashtëmujorë. Për bankat MREL, kjo rritje është përkatësisht 5.2% dhe 2.1%. Në terma të kontributit relativ në nivelin e MREL për pjesën e parë të vitit 2024, zgjerimi i vazhdueshëm i aktivitetit bankar ka kontribuar në rënien me rreth 0.4 pikë përqindje të kapacitetit MREL në muajin qershor 2024.

### III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL

Përgjatë viteve, sektori bankar është bërë më aktiv në financimin e kërkesave rregullative përmes emetimit në tregun e kapitalit në vend. Pas vitit 2021, titujt financiarë të emetuar kanë shërbyer për të plotësuar njëkohësisht kërkesën për kapital rregullator dhe MREL, ndërsa emetimet e kryera deri në vitin 2021, kanë shërbyer për plotësimin e kërkesës për kapital rregullator.


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, duke përfshirë emetimet në të gjitha monedhat, bankat MREL të sektorit bankar kanë emetuar në formën e obligacioneve me ofertë private detyrime senior të pagarantuara. Titujt financiarë të borxhit të pagarantuar, janë detyrime senior të njohura si "detyrime të pranuar", të cilat renditen menjëherë pas titujve të kapitalit rregullator, sipas ligjit nr.9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe shërbejnë për qëllime të financimit të MREL.


Grafik 9. Emetimet e letrave me vlerë, sipas monedhave, 2014 – 6MI 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, emetimet në monedhën vendase shënojnë afërsisht të njëjtin nivel me emetimet në monedhën euro dhe një pjesë më e vogël në monedhën dollarë amerikan. Për këtë periudhë, portofoli i emetimeve përbëhet nga instrumentet në formën e "obligacioneve të pagarantuara", duke mos pasur asnjë emetim të titujve financiarë të borxhit të varur.






Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, u emetuan për herë të parë tituj të borxhit të paguarantuar për qëllime të MREL, në monedhën euro dhe me afat maturimi 4 vjet. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, emetimi i titujve të borxhit të paguarantuar është realizuar si në monedhën vendase ashtu dhe në atë të huaj, kundrejt emetimit vetëm në monedhë të huaj gjatë vitit 2023.

Në lidhje me koston e financimit në tregun e kapitalit, norma e interesit ka shënuar rënie të dukshme për këtë emetim, duke reflektuar ecurinë e normave të interesit në tregun financiar, si dhe vlerësimin për primin e rrezikut të këtij instrumenti (detyrime senior të paguarantuara) kundrejt borxhit të varur. Gjithashtu, oferta e investitorëve në treg për këtë instrument gjatë kësaj periudhe, ka ndikuar në uljen e koston së financimit të këtij emetimi. Norma e interesit të këtij instrumenti të emetuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, reflekton stabilizimin e normave të interesit në tregun financiar kundrejt vitit 2023. Normat e interesit u rikthyen në nivelet e vitit 2022, duke shënuar një rënie prej rreth 2.2% për emetimin në lekë, 0.7% për euron dhe 1.7% për dollarin amerikan, krahasuar me totalin e emetimeve për vitin 2023.





## IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR


Ndikimi i përmbushjes së kërkesës për MREL në përfitueshmërinë e sektorit bankar dhe koston përkatëse të financimit, përfshin: (i) efektin që vjen nga vëllimi i emetimit të titujve të rinj financiarë për të përmbushur nivelin përfundimtar të MREL dhe norma përkatëse e interesit dhe (ii) efektin që vjen nga kosto e shërbimit të borxhit, për titujt ekzistues në bilancin e sektorit bankar, të cilët janë të pranuar për MREL.

Në mënyrë të përmbledhur, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, ecuria e normave të interesit është reflektuar në rritjen e rezultatit neto nga interesi për sektorin bankar. Kontributin kryesor e ka dhënë përmirësimi i ndjeshëm i të ardhurave neto nga interesi për të gjithë sektorin, duke rritur aftësinë e tij për të përballuar koston shtesë të financimit sipas kërkesave të reja rregullative. Për rrjedhojë, në vijim të stabilizimit të normave të interesit gjatë gjashtëmujorit të parë 2024, kosto e financimit të stokut të letrave me vlerë në bilancin e sektorit bankar mbeti e kufizuar, në kushtet e ruajtjes së treguesve të kënaqshëm të përfitueshmërisë. Ndërkohë, simulimet mbi ndikimin që mund të ketë emetimi në vijimësi i titujve të rinj financiarë për përmbushjen e nivelit përfundimtar të MREL, tregojnë ndjeshmëri ndaj luhatjeve në normat e interesit për banka të veçanta.




## ZHVILLIMET NË PËRFITUESHMËRI

Ecuria e faktorëve të përgjithshëm të ekonomisë së brendshme dhe asaj të jashtme vijon të reflektohet pozitivisht në përfitueshmërinë e sektorit bankar. Më konkretisht, në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2024, rezultati neto nga interesi shënoi një rritje vjetore prej 12%, duke shënuar një nivel prej 35.4 miliardë lekë. Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL shënuan një rezultat neto nga interesi prej 26.3 miliardë lekë, duke kontribuar në rreth 74% të totalit të sektorit. Në krahasim me gjashtëmuorin e mëparshëm, ky kontribut ka shënuar një rënie të lehtë prej 1.4 pikë përqindje.



Në të njëjtën linjë, edhe treguesi i marzhit neto të interesit, i llogaritur si raporti i të ardhurave neto nga interesi ndaj aktiveve mesatare që sjellin të ardhura, ka vijuar të reflektojë zhvillime pozitive. Në qershor 2024, ky tregues arriti në nivelin 4.36%, duke shënuar kështu vlerën maksimale që prej fillimit të vitit 2010. Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL vijojnë të ruajnë në përgjithësi një nivel lehtësisht më të ulët të rezultatit neto nga interesi në krahasim me bankat e tjera të sektorit, duke reflektuar strukturën e tyre të financimit. Gjithsesi, në mënyrë të ngjashme me vitin 2023, hendeku midis nivelit të marzhit neto nga interesi për bankat MREL krahasuar me bankat e tjera, vijon të mbetet i ngushtë. Gjatë periudhës, bankat MREL kanë shënuar norma të këtij marzhi më pranë normës së totalit të sektorit bankar, pavarësisht financimit të kërkesave rregullative specifike për këto banka.





## ZHVILLIMET NË KOSTON E FINANCIMIT


Në terma absolutë, ecuria e normave të interesit ndikon drejtpërdrejt në koston e financimit të MREL përmes emetimeve të titujve financiarë. Fokusi i kësaj analize janë bankat të cilat kanë emetuar tituj borxhi. Bankat kryejnë emetime të tilla për qëllime të përbushjes së kërkesave për kapital rregullator ose për të përbushur kërkesat për detyrime të pranuar (në rastin e bankave të cilat i nënshtrohen kërkesës për MREL).

Shpenzimet e interesit për klientët vijojnë të përbëjnë peshën kryesore të shpenzimeve të sektorit bankar. Në qershor 2024, pesha e shpenzimeve të interesit paguar klientëve qëndron në nivelin e 19.6% të rezultatit neto nga interesi. Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit të paguar për borxhin e varur zënë një peshë të vogël, prej 1.8% të rezultatit neto nga interesi. Ndërkohë, pas emetimeve në tregun financiar të instrumenteve senior, të emetuar për qëllime të përbushjes së kërkesës për MREL, shpenzimet për interesa për letrat me vlerë përbëjnë rreth 1.5% të rezultatit neto të periudhës, kundrejt nivelit 1% në fund të vitit 2023.





Grafik 14. Peshë e shpenzimeve të interesit ndaj rezultatit neto nga interesi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupit të bankave, treguesit për koston e financimit reflektojnë modelin e biznesit të bankave dhe strategjinë për financimin e aktivitetit të tyre. Konkretisht, në qershor 2024, për grupin e bankave që nënshtrohen kërkesave për MREL, shpenzimet e interesit paguar klientëve zënë 17.6% të rezultatit neto nga interesi, ndërsa shpenzimet e interesit për borxhin e varur zënë 2% të tij. Nga ana tjetër, grupi i bankave të tjera, gjithashtu paraqet shpenzime për interesa të borxhit të varur, të cilin e përdor për qëllime të përmbytjes së kërkesave për kapital rregullator. Në krahasim me bankat MREL, ky grup bankash shënon një peshë më të lartë të shpenzimeve të interesave të paguar për klientët (25.2%), por disi më të ulët për borxhin e varur (1.4%).

Duke marrë në konsideratë stokun ekzistues të borxhit të varur të mbajtur nga sektori bankar, raporti midis shpenzimeve të interesit dhe stokut të borxhit të varur shënoi një nivel prej 3.2% në fund të gjashtëmujorit të parë 2024. Për grupin e bankave MREL kjo peshë qëndron në nivelin e 3.6% për periudhën e analizuar, krahasuar me 2.2% për bankat e tjera. Raporti më i lartë i koston e financimit të stokut ekzistues të borxhit për bankat MREL në krahasim me bankat e tjera, reflekton stokun më të lartë të borxhit që mbajnë këto banka në bilanc, por edhe një aktivitet më të hershëm të emetimit të titujve të borxhit, të cilët janë akumuluar në bilanc. Gjithsesi, kjo kosto është zbutur nga kostot relative më të ulëta të financimit nëpërmjet depozitave, si dhe prej ecurisë pozitive në përfitueshmëri për bankat MREL. Në çdo rast, kosto e stokut ekzistues të borxhit të varur është përthithur dhe reflektuar në llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të bankave, pa ndikuar në mënyrë materiale në rezultatin neto financiar të tyre.

Në total, në vijim të analizave të paraqitura në këtë seksion, vlerësohet se ndikimi ende i kufizuar i përmbytjes së kërkesave rregullative për MREL në bilancin e sektorit bankar është zbutur nga disa faktorë. Së pari, nivelet e kënaqshme të kapitalizimit të këtij grupi bankash ndër vite kanë lehtësuar



procesin e përmbushjes së niveleve të ndërmjetme të MREL përmes kapitalit rezervë të lirë në bilanc. Së dyti, tregu i kapitalit në Shqipëri ka shfaqur aftësi të mira për të përthithur nevojat e bankave për financim, pa kosto të ndjeshme shtesë për bankat që i nënshtrohen kërkesave për MREL. Në tërësi, ruajtja e një besimi të shëndoshë të tregut në sektorin bankar është reflektuar në ruajtjen e kostove të financimit të titujve të borxhit, në nivele të përballueshme dhe të qëndrueshme për përfitueshmërinë e sektorit. Bankat e mëdha që u nënshtrohen kërkesave për MREL, vijojnë të reflektojnë një peshë më të ulët të shpenzimeve për interesa ndaj rezultatit neto, veçanërisht për depozitat e klientëve. Së fundi, prania e filialeve të bankave evropiane, të cilat në linjë me strategjinë e ndjekur në bankën mëmë, kanë zgjedhur të financojnë MREL përmes Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, ka lehtësuar në tërësi kërkesën për financim në tregun vendas, duke zbutur edhe presionet përkatëse në normën e interesit.


Banka e Shqipërisë do të vijojë të monitorojë me kujdes zhvillimet në koston e financimit të kërkesave rregullative përgjatë periudhës tranzitore deri në fund të vitit 2027, në kushtet e rritjes graduale të nivelit të ndërmjetëm të kërkesës për MREL.

#### HAPËSIRË INFORMUESE. NDIKIMI I RITJES SË NORMAVE TË INTERESIT NË KOSTON E FINANCIMIT TË MREL


*Analiza e mëposhtme vlerëson ndjeshmërinë e treguesve të përfitueshmërisë së bankave MREL, në rast se rritja e normës së interesit rezulton në kosto më të larta rifinancimi, në krahasim me periudhën në të cilën është emetuar fillimisht titulli i borxhit. Bankat që kanë emetuar borxh të varur me maturitet afatmesëm mund të jenë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit.*

*Për të kryer një vlerësim paraprak mbi ndikimin e ndryshimit të këtyre normave nëpërmjet simulimeve hipotetike, konsiderohet që të gjitha bankat janë në përmbushje të plotë të kërkesave për MREL, si për objektivat e ndërmjetëm, ashtu edhe për objektivin përfundimtar të vitit 2027. Simulimet mbështeten në supozimin e një bilanci statik deri në vitin 2027. Gjithashtu, simulimet nuk marrin në konsideratë ndryshimet e mundshme në kërkesat rregullative mbikëqyrëse apo makroprudenciale gjatë kësaj periudhe. Së fundi, analiza përjashton bankat që tashmë e plotësojnë nivelin përfundimtar të kërkesës për MREL dhe analizon vetëm ato banka që ende kanë nevojë të emetojnë tituj financiarë për të përmbushur objektivin përfundimtar. Këto banka zënë 49.9% të aktiveve të sektorit bankar.*

*Ndikimi i përmbushjes së kërkesës MREL në përfitueshmërinë e bankave vlerësohet në dy drejtime. Së pari, vlerësohet kosto e financimit të stokut aktual të detyrimeve të pranuar dhe së dyti, merren në konsideratë nevojat vjetore shtesë për financimin e MREL deri në arritjen e objektivit përfundimtar në vitin 2027. Në këto kushte, në skenarin bazë, supozohet që normat e interesit nuk pësojnë ndryshime përgjatë viteve 2024-2027. Më tej, në dy skenarët hipotetikë supozohet një rritje e normës së interesit përkatësisht me 1 dhe 2 pikë përqindje gjatë kësaj periudhe. Pas vlerësimeve të kryera, rezultatet e kësaj analize paraqiten në mënyrë të përmbledhur në grafikun e mëposhtëm.*



Grafik 15. Ndikimi i ndryshimit të normës së interesit në shpenzimet e interesit të borxhit (në terma mesatarë)



Rezultatet e analizës së përmblodhur në grafikun 16 tregojnë se kostoja e përbushjes së MREL paraqitet e përballueshme, duke arritur në 6.1% të të ardhurave neto nga interesi në vitin 2027. Për të gjitha bankat, vlerësohet që kosto e financimit të detyrimeve të pranvara mund të përthithet plotësisht në rezultatit neto financiar të bankave, pa ndikuar ndjeshëm në përfitueshmërinë e tyre. Gjithsesi, duhet theksuar se analiza nuk merr në konsideratë përforsimin e vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit të bankës përmes certifikimit të fitimit, i cili zbut pjesërisht efektin që vjen nga nevoja e sektorit bankar për të financuar MREL përmes emetimit të borxhit të ri.

Në tërësi, vlerësohet se kosto për shërbimin e borxhit për qëllime të MREL do të vijojë të shënojë rritje për të gjitha bankat, por mbetet e kufizuar në terma relativë të treguesve të përfitueshmërisë. Zhvillimet e sektorit bankar gjatë periudhës, veçanërisht forcimi në vijimësi i pozicionit të kapitalit rregullator përmes rritjes së fitimit të pashpërndarë, ul ndjeshëm nevojën shtesë për financim të MREL dhe përbën faktorin kryesor zbutës së kostonë së financimit. Në çdo rast, sektori bankar vijon të raportojë vlera të kënaqshme të rezultatit neto nga interesi dhe të treguesve të përfitueshmërisë, edhe në skenarët më të rënduar.

